



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr.122/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Hasan Shala dhe Nenad Laziç anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Podujevë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Grupimi Tradicional Shqiptar, dega në Podujevë, për shkak të vendosjes së banerëve në rrugën publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 05.06.2014, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Podujevë, kështu që subjektit politik Lëvizja Grupimi Tradicional Shqiptar, dega në Podujevë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 250 (dyqind e pesëdhjetë ) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 04.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Podujevë me të cilën pretendon se me datën 03.06.2014, në ora 11:00 anëtarë të subjektit politik Lëvizja Grupimi Tradicional Shqiptar, në rrugën publike Zahir Pajaziti në Podujevë, kanë vendosur banerë të kandidatëve për Kuvendin e Republikës së Kosovës Salih Salih dhe Rama Pollomi nga ky subjekt politik. Me këtë rast parashtresuesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e nenit 4 paragrafi 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 Kodi i Mirsjelljes për subjekte politike, mbeshtetësit e tyre dhe kandidatet.

Parashtresuesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, PZAP me datë 04.06.2014 e informoi subjektin politik Lëvizja Grupimi Tradicional Shqiptar për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në Kërkesë Përgjigje dhe Urdhër për të ndermarr masat permirsuse lidhur me ankesën deri në datë 05.06.2014 në ora 11:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Lëvizja Grupimi Tradicional Shqiptar në të cilën deklaroi se shtabi zgjedhor i Lëvizjes Grupimi Tradicional Shqiptar në Podujevë ka ndërmarr të gjitha masat permirsuese

ku me ç'rast me datën 04.06.2014, i ka larguar të gjithë banerat për të cilat është parashtruar ankesa.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

#### **ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se banerët e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik Levizja Grupimi Tradicional Shqiptar janë të vendosura mbi rrugët publike, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rëndësuese mori se subjekti politik Levizja Grupimi Tradicional Shqiptar ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se banerat e kandidatëve për deputet kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e tyre. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik Levizja Grupimi Tradicional Shqiptar, pas marrjes së Kërkesës Pergjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masa Përmirësuese nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë banerat nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik Levizja Grupimi Tradicional Shqiptar është shkelur neni 33 pika b) të LZP-së, pasi që banerat e kandidatëve të saj janë vendosur mbi rrugë publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik Levizja Grupimi Tradicional Shqiptar që ka ndërmarr për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të disa fotografive të cilat i ka ofruar si prove të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në

lartësinë e gjobës së shqiptuar, PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 122/2014 më datën 05.06.2014.

Kryesuesi i Panelit

Xhevdet Abazi



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*